



# USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 29 (827676)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 24 korrik 2020

## Akademia e Forcave të Armatosura



### "Bachelor" në Shkenca Ushtarake, 60 kandidatë për ciklin e parë

Akademia e Forcave të Armatosura, për vitin Akademik 2020-2021 do të rekrutojë 60 (gjashtëdhjetë) kandidatë për oficerë, për të ndjekur studimet në ciklin e parë "Bachelor" në Shkenca Ushtarake. Me qëllim vijimin e mëtejshëm të procedurave për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, të cilët do të ndjekin

studimet në ciklin e parë "Bachelor" në Shkenca Ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura, në linket e mëposhtëm dokumentacioni i nevojshëm: Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, që do të ndjekin studimet në ciklin e parë "Bachelor" në "Shkenca Ushtarake"...

»» faqe 4

Gjenerallejtënant Eric P. Wendt në Tiranë

## Gjeneral brigade Kollçaku pret komandantin e Forcave Speciale të NATO-s



»» faqe 2

## Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)

# Ministria e Mbrojtjes-UNDP: Fillon projekti për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të fatkeqësive

Projekti do të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë drejt anëtarësimit me të drejta të plota në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit European »» faqe 3



## Shkolla e Trupës në Bunavi

### Bunavi, betohen 116 ushtarët e rinj të Forcave të Armatosura

Në mjediset e Shkollës së Trupës, Bunavi, pavarësisht kufizimeve të imponuara nga pandemia e "COVID-19", u zhvillua më 20 korrik 2020, ceremonia e betimit dhe çertifikimit të rekrutëve, të cilët përfunduan Kursin e Stërvitjes Individuale Bazë. Në përfundim të këtij kursi u çertifikuan 116 rekrutë, të rinj e të reja, nga mbarë vendi, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave tona të Armatosura...



»» faqe 5

## SHBA aleati ynë strategjik

### Në vitet e fundit, 180 milionë USD asistencë për mbrojtjen

Modernizimi i Forcave të Armatosura, për të qenë një aleat i denjtë i NATO-s, është një prioritet i qeverisë shqiptare dhe politikave të ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë sfidë të vërtetë, një rol po luajnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo, jo vetëm në rritjen profesionalisht të kapaciteteve njerëzore, por edhe në nivelin teknik...

»» faqe 5



Mali i Zi - Republika e Francës

## Projekte në fushën e industrisë ushtarake dhe kërkimit shkencor

»» faqe 12

MODERNIZIMI I EMERGJENCAVE CIVILE

### Bazë logjistike me standardet më të mira ndërkombëtare

»» faqe 2

HISTORI

### Lufta e Koplikut 1920 dhe disa veçori ushtarake

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

»» faqe 6



Gjeneralletënant Eric P. Wendt në Tiranë

# Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku pret komandantin e Forcave Speciale të NATO-s

*Bashkëpunim në përgatitjen e zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të forcave speciale*




Në takim u diskutua për situatën e sigurisë në rajon e më gjerë në zonat e përgjegjësisë dhe interesit të Aleancës dhe nevojat për bashkëpunim në përgatitjen e zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të forcave speciale.

Këto ditë zhvilloi një vizitë në Forcat tona të Armatosura komandanti i Forcave Speciale të NATO, gjeneralletënant Eric P. Wendt. Gjenerali Wendt u prit dhe zhvilloi një takim me shefin e Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.

Në takim u diskutua për situatën e sigurisë në rajon e më gjerë në zonat e përgjegjësisë dhe interesit të Aleancës dhe nevojat për bashkëpunim në përgatitjen e zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të forcave speciale.

Forcat Speciale të NATO-s (SOF) ofrojnë shërbime për Forcat Ajrore, Detare dhe Tokësore të NATO-s dhe janë të rëndësishme në të gjithë gamën e plotë të operacioneve ushtarake. Këto aftësi të SOF janë gjithashtu të zbatueshme për detyrat thelbësore të Aleancës për mbrojtjen kolektive, menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese. Selia e Operacioneve Speciale të NATO-s (NSHQ) është pika kryesore e zhvillimit, koordinimit dhe drejtimit për të gjitha aktivitetet e Operacioneve Speciale të NATO-s.



## Kush është gjeneralletënant Eric P. Wendt?

Përveç pozicioneve të shumta, duke përfshirë shërbimin si Ndihmësi Kryesor Ushtarak i Sekretarit të Mbrojtjes, ai ka komanduar në çdo nivel të Forcave Speciale nga A-Team (ODA) deri në Komandën e Operacioneve Speciale të Teatrit Nën-Unifikuar (TSOC).

Gjeneralletënant Eric P. Wendt flet anglisht, arabisht dhe gjuhën koreane. Atij i është akorduar "Kryqi i Artë Gjerman i Nderit" për shërbimin luftarak në Afganistan, medalja "Cheon Su" nga Presidenti i Republikës së Koresë, etj. Gjeneralletënant Eric P. Wendt ka qënë edhe Koordinator i Sigurisë së Shteteve të Bashkuara, Izraelit dhe Autoritetit Palestinez. Gjeneralletënant Eric P. Wendt mori komandën e Forcave Speciale të NATO-s, në 7 Nëntor 2019.



Gjeneralletënant Eric P. Wendt është një ushtarak amerikan karriere. Ai ka një diplomë "Bachelor" nga Universiteti i Kalifornisë në Santa Barbara në "Drejtësi dhe Shoqëri" dhe një Master për "Çëshjtje të Sigurisë Kombëtare" nga Shkolla Pasuniversitare Detare në Monterey, California.

Eric P. Wendt ka një karrierë të gjatë ushtarake. Ai ka shërbyer si një oficer aktiv i ushtrisë amerikane që nga viti 1986. Ai shërbeu gati pesë vjet në

këmbësori, dhe më pas ka shërbyer si një Green Beret, oficer i forcave speciale.

Wendt ka shërbyer në disa vende të botës, si në: Indonezi si Shef Ekipi për Komandantin e Komandës së SHBA-ve në Paqësor, në Ekipin e Vlerësimit të Situats së Paqësorit (PSAT), në operacionin Liria e Qëndrueshme-Filipine (OEF-P) në Mindanao në jug të Filipineve, në Operacionin Liria e Irakut (OIF) dhe në Operacionin Liria e Përhershme-Afganistan (OEF-A).

STAFI

**DED KOLA**  
Shef i Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

**Gazetarë:**  
Mimoza **GOLIKJA**

**Gazetarë:**  
Saimir **ALIJA**

**Graphic Designer:**  
Afërdita **HYSAJ**

**ADRESA:**  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni "Skënderbej"



# Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)

## Ministria e Mbrojtjes-UNDP: Fillon projekti për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të fatkeqësive

*Projekti do të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë drejt anëtarësimit me të drejta të plota në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit European*

**M**odernizimi i Emergjencave Civile po vijon me pajisjen e këtyre strukturave me bazë logjistike, të nivelit të parë të standardeve më të mira ndërkombëtare.

Kryeministri Edi Rama ndau ditën e shtunë me 18 korrik 2020, disa foto nga pajisjet e reja dhe stërvitja në bazë të protokolleve të reja me të gjitha standardet ndërkombëtare.

“Vijon modernizimi i forcës sonë të Emergjencave Kombëtare, të cilat po plotësohen me një bazë logjistike të nivelit të parë dhe kanë nisur edhe stërvitjet në bazë të protokolleve të reja me të gjitha standardet ndërkombëtare”, - tha Rama. Në muajin prill, Emergjencat Civile u pajisën me flotën e re të autoambulancave, të cilat erdhën nga Turqia.

Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes civile, prej kohësh ka marrë vëmendjen dhe përkushtimin e ministrisë së Mbrojtjes dhe qeverisë shqiptare. Këtij qëllimi do t'i shërbejë projekti “Forcimi i aftësisë ripërtëritëse në Shqipëri”, i cili u inaugurua të premten që kaloi, më datë 17 korrik 2020, nga ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka dhe përfaqësueses së përhershme të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Limya Eltayeb.

“Dokumenti që nënshkruam pak më parë, mbështetet në sugjerimet që ekspertët vendas dhe të Bashkimit European, Bankës Botërore dhe UNDP, dhanë në raportin e vlerësimit të nevojave, pas tërmetit të 26 Nëntorit të vitit të kaluar. Kurrë më shumë sesa në ato ditë të vështira, nuk ka qenë më i vyer mendimi i ekspertëve vendas e të huaj, për të përmirësuar Sistemin e Mbrojtjes Civile, mbështetur në koordinimin dhe bashkëpunimin institucional, në zhvillimin e kornizës që mundëson zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive natyrore, apo duke rritur kapacitetet përgatitore dhe reaguese të strukturave, dedikuar fatkeqësive natyrore në nivel qendror apo vendor.

Bazuar edhe mbi këtë projekt, do të mund të hartojmë kodet e reja të ndërtimit apo çka është më e rëndësishmja, do të realizojmë për herë të parë Vlerësimin e Riskut nga fatkeqësitë në nivel kombëtar, e për rrjedhojë dhe strategjinë kombëtare për zvogëlimin e riskut të fatkeqësisë dhe procedurat standarde të operimit në rastet e fatkeqësisë. Sot, nisi puna për një projekt ambicioz, për të cilin ne në ministrinë e Mbrojtjes ndjehemi krenarë, pasi në pak vite, bashkë me ligjin e ri “Për Mbrojtjen Civile”, ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, forcimit të kapaciteteve të FA në kuadër të emergjencave civile, po hedhim gurët e themelit të një prej sistemeve më të rëndësishme, që mbron atë çka është më e shtrenjtë për secilin prej nesh: “jetën”, - deklaroi ministrja Xhaçka.

Aktualisht, UNDP po vë në zbatim dy iniciativa pilote në nivel qendror dhe vendor, përkatësisht vlerësimin e kapaciteteve institucionale, ku përfshihen institucionet e rëndësishme qendrore dhe bashkëpunimi me bashkinë e Lezhës për të zhvilluar profilin e saj të riskut dhe planin vendor të Mbrojtjes Civile, duke mundësuar kështu terrenin



për një përshkallëzim të përpjekjeve të gatishmërisë dhe të përgjigjes.

“Fatkeqësitë natyrore kanë fuqinë që të përmbysin rritjen ekonomike dhe progresin e arritur, të rrisin pabarazinë e ekspozimit ndaj riskut dhe të godasin më rëndë ata që kanë vështirësi më të mëdha ekonomike dhe sociale. Fatkeqësitë natyrore kanë qenë dhe vijojnë të jenë pjesë e realitetit tonë dhe pashmangshmërisht do të kemi një përkeqësim të mëtejshëm të këtyre fenomeneve nga ndryshimet klimatike. Reduktimi i riskut nga fatkeqësitë lidhet me mbrojtjen e jetëve njerëzore, me varfërinë, bizneset dhe mjetet e jetesës për ne dhe

brezat e ardhshëm. Në cilësinë e saj, si një organizatë botërore për zhvillim, UNDP promovon qeverisjen e mirë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të cilat kanë në qendër të tyre qeniet njerëzore nën moton “Askush të mos mbetet pas”. Qëndrueshmëria ka nevojë për aftësi ripërtëritëse. Reduktimi i riskut nga fatkeqësitë është mënyra e vetme për të garantuar se fatkeqësitë natyrore, nuk do ta nxjerrin zhvillimin e qëndrueshëm nga binarët. E për rrjedhojë, ne kemi vetëm një mundësi: të përgatitemi për të zbutur ndikimet nga fatkeqësitë natyrore dhe, kur ato të ndodhin, të jemi të aftë të përgjigjemi në kohë për të shpëtuar sa më shumë jetë. Nëse vihet plotësisht në zbatim, ne jemi besimplotë se ky program do të shënojë një pikë kthese në Menaxhimin e Riskut nga Fatkeqësitë për Shqipërinë”. - u shpreh znj. Limya Eltayeb, përfaqësuese e përhershme e UNDP.

Projekti do të mbështesë gjithashtu përpjekjet e Shqipërisë, për t'u anëtarësuar me të drejta të plota në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit European, në pajtim me parimet e Kuadrit të Sendait për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë (KSRRF) dhe me rekomandimet e Vlerësimit të Nevojave pas Fatkeqësisë Natyrore (VNFN) në vazhden e tërmetit të 26 Nëntorit në Shqipëri.

### Modernizimi i Emergjencave Civile

## Bazë logjistike me standardet më të mira ndërkombëtare

**M**odernizimi i Emergjencave Civile po vijon me pajisjen e këtyre strukturave me bazë logjistike, të nivelit të parë të standardeve më të mira ndërkombëtare.

Kryeministri Edi Rama ndau ditën e shtunë me 18 korrik 2020, disa foto nga pajisjet e reja dhe stërvitja në bazë të protokolleve të reja me të gjitha standardet ndërkombëtare.

“Vijon modernizimi i forcës sonë të Emergjencave Kombëtare, të cilat po plotësohen me një bazë logjistike të nivelit të parë dhe kanë nisur edhe stërvitjet në bazë të protokolleve të reja me të gjitha standardet ndërkombëtare”, - tha Rama. Në muajin prill, Emergjencat Civile u pajisën me flotën e re të autoambulancave, të cilat erdhën nga Turqia.



**FORÇA DETARE**  
**Çertifkohen**  
**tre oficerë të**  
**grupeve patrulluese**  
**të anijeve**

Në anijen e klasit Iliria P-133 Lissus, u zhvillua ceremonia e dhënies së certifikatave për vetëdrejtimin autonom të komandimit të anijeve klasi A-1. Ceremonia u zhvillua në gjirin e Durrësit, ku u certifikuan tre oficerë të grupeve patrulluese të anijeve të Forcës Detare. Çertifikatat u dhanë nga zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiten i rangut të parë, Artur Meçollari, i cili u uroi suksese të mëtejshme dhe erëra të mbara.



## AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

# "Bachelor" në Shkenca Ushtarake, 60 kandidatë për ciklin e parë

**A**kademia e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020-2021 do të rekrutojë 60 (gjashtëdhjetë) kandidatë për oficerë, për të ndjekur studimet në ciklin e parë "Bachelor" në Shkenca Ushtarake. Me qëllim vijimin e mëtejshëm të procedurave për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, të cilët do të ndjekin studimet në ciklin e parë "Bachelor" në Shkenca Ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura, në linket e mëposhtëm dokumentacioni i nevojshëm:

Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e kandidatëve për oficerë, që do të ndjekin studimet në ciklin e parë "Bachelor" në "Shkenca Ushtarake" në Akademinë e Forcave të Armatosura, "Aneksi A"-Formulari i të dhënave personale të aplikantit. "Aneksi B"-Formular Vetëdeklarimi. "Aneksi C"-Formular vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore të kandi-

datit për oficerë aktiv. Pranimi në programin e studimit "Bachelor" në Shkenca Ushtarake është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurrim, ku 60% të vlerësimit e zë rezultati i konkurrimit dhe 40% e zë rezultati i maturës shtetërore. Për t'u pranuar në këtë cikël studimi, aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta.



## PROCEDURAT E REKRUTIMIT PËR OFICERË

## "Bachelor" në Shkenca Ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura

**A**kademia e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020-2021 do të rekrutojë 60 (gjashtëdhjetë) kandidatë për oficerë, për të ndjekur studimet në ciklin e parë "Bachelor" në Shkenca Ushtarake.

## Kriteret e pranimi të kandidatëve

Pranimi në programin e studimit "Bachelor" në Shkenca Ushtarake është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit dhe që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurrim, ku 60% të vlerësimit e zë rezultati i konkurrimit dhe 40% e zë rezultati i maturës shtetërore. Për t'u pranuar në këtë cikël studimi, aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta si më poshtë:

## Kritere të përgjithshme:

të ketë shtetësi shqiptare; të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë; të mos jete i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë; të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik.

## Kritere të veçanta:

Të jetë i aftë nga ana shëndetësore; të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat; të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm pa mangësi apo shenja që deformojnë pamjen e jashtme; të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (semundjeve seksualisht te transmetueshme), të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga semundje të tjera të zemrës, veshkave, hepaticke, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i levizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike; e) të mos jetë i martuar. Kandidati që nuk plotëson kriteret e përcaktuara më sipër squalifikohet.

## Procedurat e aplikimit dhe konkurimit

Kandidatët që rezultojnë fitues nga konkurrimi në portal

www.ualbania.al (matura shtetërore) për ndjekjen e programit "Bachelor" në Shkenca Ushtarake, paraqiten personalisht pranë Sekretarisë Mësimore të Akademisë së Forcave të Armatosura ku plotësojnë formularin e aplikimit për këtë program, si dhe paraqesin dokumentacionin përkatës. Kandidatët e rregjistruar i nënshtrohen procesit të testimit i cili konsiston: Ekzaminimin e gjendjes shëndetësore; Testim fizik; Intervistë; Proces i testimit organizohet dhe drejtohet nga Komisioni ad hoc, bazuar në këtë rregullore dhe sipas vendimeve të autoriteteve drejtuese të këtij programi. Ky proces do të zhvillohet sipas parimit të mosdiskriminimit dhe të vlerësimit objektiv dhe të drejtës për aplikim, duke vlerësuar në mënyrë të paanshme të gjithë dokumentacionin e paraqitur dhe duke motivuar të gjitha rastet e mospranimit në këtë program studimi.

Shpallen fitues kandidatët që janë vlerësuar me numrin maksimal të pikëve në rend zbritës, deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimi. Kjo kuotë bëhet publike që në fillimin e aplikimeve.

Kandidati fiton të drejtën për të filluar studimet në Akademinë e Forcave të Armatosura në programin e studimit "Bachelor" në Shkenca Ushtarake, kur regjistrohet në Sekretarinë Mësimore të fakultetit sipas udhëzimeve të dhëna nga MASR, në të kundërt, ai humbet të drejtën për ndjekjen e studimeve në AFA.

Lista e kandidatëve fitues për programin "Bachelor", shpallet në mjedise të dukshme në Akademinë e Forcave të Armatosura, websitin zyrtar të saj (www.tradoc.mil.al) dhe Ministrisë së Mbrojtjes (www.mbrojtja.gov.al). Kandidatët që nuk shpallen fitues, kanë të drejtën e ankimit në Akademinë e Forcave të Armatosura, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. Rektori jep përgjigje të motivuar, në formë të shkruar, brenda 7 ditëve nga paraqitja e ankesës. Kandidati që nuk ka fituar mund të konkurrojë përsëri në vitin pasardhës.

## Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidatët që do të rekrutohen për të ndjekur studimet në ciklin e parë "Bachelor" në "Shkenca Ushtarake" në Akademinë e Forcave të Armatosura, dhe rezultojnë fitues nga matura shtetërore, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: Në fazën e regjistrimit a) kërkesë me shkrim për ndjekjen e studimeve ushtarake; b) formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A, bashkëlidhur këtij dokumenti; c) formular i vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore i cili plotësohet pranë AFA-së në momentin e dorëzimit të

dokumentacionit. d) fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me listen e notave; e) fotokopje e kartës së identitetit; f) certifikatë familjare, 1 copë; g) fotografi për dokument (4x6), 2 copë; h) raportin mjekoligjor të lëshuar nga Komisioni Mjekoligjor i Qendrës Shëndetësore të vendbanimit; i) analizat e gjakut për Hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombetare e Transfuzionit të Gjakut ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shendetit Publikë në rrethet ku banojnë.

Në përfundim të konkurimit a) dëshmi penalteti; b) vërtetim nga përbarimi; c) vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor; d) vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi.

## Periudha e konkurimit

Afatet e konkurimit janë të përcaktuara në urdhrin e përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH) nr. 02 datë 02.07.2020 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programin e ciklit të parë të studimeve, në programet e integruara të studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të dytë të studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë për vitin akademik 2020-2021".

Shënim: Personi që aplikon deklaron se të dhënat e paraqitura në formularë përkatës janë të vërteta dhe autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjelljes përjashtimit nga çdo procedurë e mëtejshme.



## SHKOLLA E TRUPËS NË BUNAVI

# Bunavi, betohen 116 ushtarët e rinj të Forcave të Armatosura

*116 vajza dhe djem u betuan në Shkollën e Trupës në Bunavi, si ushtarët më të rinj të Forcave të Armatosura të Shqipërisë*

Në mjediset e Shkollës së Trupës, Bunavi, parësisht kufizimeve të imponuara nga pandemia e "COVID-19", u zhvillua më 20 korrik 2020, ceremonia e betimit dhe certifikimit të rekrutëve, të cilët përfunduan Kursin e Stërvitjes Individuale Bazë. Në përfundim të këtij kursi u certifikuan 116 rekrutë, të rinj e të reja, nga mbarë vendi, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave tona të Armatosura.

"116 vajza dhe djem u betuan në Bunavi, si ushtarët më të rinj të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ripërtëritja e trupave është një cikël i zakonshëm në FA, por kësaj radhe dua t'i përgëzoj posaçërisht ushtarët e rinj, për vullnetin dhe sakrificën e jashtëzakonshme në këto kohë pandemie. Stërvitja në Shkollën e Trupës, nuk ishte aspak si herët e tjera dhe për këtë përgëzoj edhe instruktorët, të cilëve u desh të përshtateshin me kufizimet e COVID-19", shkruan ministria Xhaçka në facebook.

Betimi i ushtarëve të rinj erdhi pas përfundimit me sukses të Stërvitjes Individuale Bazë, e cila kësaj radhe u zhvillua në kushte jo të zakonshme, për shkak të pandemisë.

Rekrutët e rinj u testuan për COVID-19, në Tiranë, përpara nisjes së stërvitjes dhe gjatë qëndrimit në Shkollën e Trupës në Bunavi, iu nënshtruan kontrolleve periodike mjekësore.

Pjesët e programit stërvitor që zakonisht zhvillohen në klasa apo palestër, u improvizuan në mjedise të hapura, ndërkohë që edhe akomodimi i rekrutëve u bë duke respektuar masat kundër përhapjes së pandemisë. Ushtarët e sapo betuar iu nënshtruan tre periudhave të stërvitjes, asaj të gjelbër, blu dhe të kuqe.

Ushtarët e rinj i përgëzoi edhe shefi i Shtabit të Shkollës së Trupës, nënkolonel Bujar Fejzo, i cili falenderoi edhe personelin trajnues. "Kjo ditë është e veçantë, pasi u betuan si ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, para flamurit tonë kombëtar, për t'i qëndruar besnik atdheut, detyrës dhe ligjit. Ndihe mi krenar për produktin e punës suaj, për këtë forcë të madhe ushtarakë që keni stërvitur, për përpjekjet e vazhdueshme tuaja në drejtim të konsolidimit të sistemit të stërvitjes së ushtarit të Forcave të Armatosura, për ambicien tuaj për të zbatuar standarde të avancuara në procesin stërvitor, për gjithçka që ju keni bërë për edukimin e këtyre të rinjve, tashmë të denjë për të shërbyer në radhët e Forcave të Armatosura".

Në veçanti, shefi i Shtabit të Shkollës së Trupës, falenderoi rekrutët e sapo certifikuar: "Ju shpreh mirënjohjen time për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar, për atë që ju reflektuat gjatë stërvitjes këtu në Bunavi, jam i sigurt se dijet dhe aftësitë e fituara do t'ju shërbejnë për të rritur më tej profesionalizmin tuaj."

Pas betimit dhe titullimit si ushtarë apo detarë të Forcave të Armatosura, efektivet e rinj do të emërohen në forcat apo komandat e ndryshme.



## SHBA ALEATI YNË STRATEGJIK

## Në vitet e fundit, 180 milionë USD asistencë për mbrojtjen

Modernizimi i Forcave të Armatosura, për të qenë një aleat i denjtë i NATO-s, është një prioritet i qeverisë shqiptare dhe politikave të ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë sfidë të vërtetë, një rol po luajnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo, jo vetëm në rritjen profesionalisht të kapaciteteve njerëzore, por edhe në nivelin teknik.

"Krah për krah me aleatin tonë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës për rritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura. Në Policinë Ushtarakë, falë mbështetjes së Ambasadës së SHBA në Tiranë, janë ndërtuar mjediset e reja të ndalimit disiplinor. Bashkëpunimi do të vijojë me trajnimin e special-



istëve të hetimit në Forcat e Armatosura", ka postuar mesazhin e saj ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka në facebook.

Kurse ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, Yuri Kim, në intervistën e datës 10 korrik, publikuar në shtypin shqiptar, shprehej se: "Mund të them se jemi krenarë të jemi aleatë në NATO me Shqipërinë. Mendoj që për ne, është shumë e rëndësishme. Secili aleat me të cilin jemi krah për krah në NATO, është i rëndësishëm. Për Shqipërinë, Shtetet e Bashkuara kanë investuar shumë e shumë miliona dollarë, tek marrëdhënia dhe tek përpjekja për të përmirësuar kapacitetet e Shqipërisë si aleate. Mendojmë se janë para të shpenzuara mirë. Kur shohim kontributet e ushtrisë shqiptare, të forcave shqiptare, madje duke përfshirë edhe sakrificën e jetës hera-herës, jemi krenarë të jemi aleatë tuaj. Mendoj se deri tani, kemi ofruar mbi 180 milionë dollarë në asistencë për mbrojtjen, vetëm në pak vitet e fundit"- u shpreh ambasadorja.

## REPUBLIKA E LETONISË

## Shqipëria me kontingjent të ri në grup-batalionin e NATO-s



Tashmë Shqipëria do të jetë me kontingjentin e saj të radhës në grup-batalionin e NATO-s, në Letoni. Kontingjentit VII EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin enhanced Forward Presence (EFP) të NATO, si pjesë e grup-batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze, të dislokuara në Letoni, u përcoll nga gjeneral brigade Bardhyl Kollcaku. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, bëri të ditur se ceremonia e ndërrimit të trupave u zhvillua pak ditë më parë në Camp Adazi, Letoni. Ndërkohë, kontingjenti i VI EOD është kthyer në Shqipëri, duke përfunduar me sukses misionin e tij.

Kontingjentit VII EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin enhanced Forward Presence (EFP) të NATO, si pjesë e grup-batalionit të udhëhequr nga forcat kanadeze, të dislokuara në Letoni, u përcoll nga gjeneral brigade Bardhyl Kollcaku.



NË KUADRIN E 100 VJETORIT TË ZHVILLIMIT TË SAJ



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Gjithmonë në luftë  
me pushkë dhe penë

Në luftërat mbrojtëse me pushkë dhe penë shqiptarët në çdo periudhë janë ngritur dhe mbrojtur vendin ndaj lakmitarëve fqinjë të tij. Në Shqipërinë e Veriut lakmitë e serbo-malazezëve kanë qenë të shumta. Këto u rritën pas vitit 1831, kur u shënuar dhe rënia e dinastisë së Bushatllinjëve të Shkodrës. Disa nga luftërat e zhvilluara pas kësaj janë e Vraninës në vitin 1861, e Kernicës në vitin 1862, e Shpuzës në vitet 1876-1877, e Potgoricës në vitin 1877, e Tivarit në nëntor 1877-janar 1878). Më tej vijuan luftërat heroike në mbrojtje të trojeve shqiptare nga vendimet e Traktatit të Shën Stefanit, të Kongresit të Berlinit të vitit 1878. Veçohen luftërat e viteve 1878-1881 në mbrojtje të Hotit, Grudës, Plavës, Gucisë, Ulqinit etj. Historia ushtarake i ka vlerësuar heroike dhe protagoniste kanë qenë malësorët, shkodranët, dukagjinast, kosovarët dhe më gjerë të drejtuar nga "Lidhja shqiptare e Prizrenit" e vitit 1878. Kjo lidhje u organizua me degë në të gjithë Shqipërinë, ku në krye ishin figura të shquara shqiptare. Në këto vite për mbrojtjen e territoreve shqiptare u luftua me armë nga shqiptarët, por dhe u "luftua" dhe me rrugë diplomatike, si në organizimin e kërkesave, të peticioneve dhe të memorandumëve. Në këto luftëra u bënë simbol për mbrojtjen e territoreve shqiptare Smajl Martini nga Gruda, Ded Gjon Luli nga Hoti, Sokol Mustaf Bajraktari nga Kopliku, Mirash Musa nga Grizha etj. Luftërat e përpjekjet për mbrojtjen e territoreve nga lakmitë sllavë fqinj nuk rreshtën edhe me fillimin e shek. XX. Trevat shqiptare u gjetën përsëri me pushkë e me penë në dorë. Viti 1911, ishte vitit i kryengritjeve antiosmane për të fituar flamurin kombëtar, që çuan në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912 nga Ismail Qemal Vlora.

Edhe shek. XX shënoi përsëri lakmitë e fqinjëve verior të mbështetura nga vendime të tjera antishqiptare të Evropës të vitit 1913, të vitit 1915, vendime këto që u shoqëruan me luftëra të vijueshme të cilët nuk donin Shqipëri. Por Malësia e Madhe e gjendur pranë vëllezërve shkodranë e dukagjinast ngritën barrikada dhe u ndeshën me lakmitë e fqinjët verior. Kelmendi u dogj më 16 gusht 1914, pushtimi i Hotit dhe Kastratit, sulmet ushtarake për Shkodrën, etj., ishin sinjale që jepeshin për nisjen e pushtimit të territoreve shqiptare. Evropa pas Luftës së Parë Botërore ja dorëzoi Shkodrën forcave ndërkombëtare, francezëve që ishin miq të sllavëve. U rindez fantazia e Malit të Zi, jo vetëm për Shkodrën, por deri në lumin Mat.

### Organizimi i luftës

Organizimi i Luftës së Koplikut u bë me miratimin e Qeverisë shqiptare të dalë nga Kongresi i Lushnjës. Kjo luftë mbrojtëse u bë e organizuar nga një Qeveri Kombëtare që nga koha

# Lufta e Koplikut 1920 dhe disa veçori ushtarake



e Skënderbeut, u bë luftë e qëndresës popullore. Në ditët e para të gusht, në shtabin e mbrojtjes të ngritur në Çesmë të Koplikut, shkuan ministri i Brendshëm Ahmet Zogu dhe patrioti e komandanti i forcave ushtarake Bajram Curri.

Nga dokumente të kohës ushtria vullnetare e Malësisë së Madhe përbëhej nga çeta e Rapsh dhe çeta e Traboinit të Hotit, çeta e Grudës, e Kastratit, e Shkrelit, e Rrjollit, e Buzës së Ujit, e Lohja e Reçit, e Grizhës, e Gruemirës, e Kopliku dhe e Koplikut të Sipërm (Bogiq, Palvar, Dobre). Këto çeta mbrojtës drejtoheshin nga Deli Meta, Luc Nishi e Zef Prel Martini nga Hoti, Gjok Dod Preçi, Zenel Shabani, Gjelosh Gjoka, Gjeto Daka e Dedush Marashi nga Kastrati, Zef Martin Ivezaj dhe Prek Ded Gjolaj nga Gruda, Vat Marashi (Vrith) e Kanto Marashi (Zagore) nga Shkrelit, Nuz Sokol Bajraktari, Keq Sadik Balaj nga Reçi, Bajram Hyseni (Linaj), Bisho Abdyl Sulaj nga Gruemira, Islam Hajdari (Leporosh), Oso Met Beqiraj (Egç-Rrjoll), Selman Bajram Ramçaj (Gruemirë-Çesmë), Smajl Delia e Tom Ded Sina nga Lohë e Sipërme, Tafil Bejtja e Qerim Zymeri nga Kopliku i Sipërm, Mustaf Bishi nga Lohë e Poshtme. Kelmendi kishte të organizuar çetën e vet me komandant Prek Cali.

Në rrethinat e Shkodrës u organizuan çeta me komandant Sylço beg Bushati, Hamit Gjylbegu, Adem Haxhia e Can Osmani (Postribë), Vat Sokoli (Shalë), Shuk Gurakuqi, Muharrem Kazazi, Zef Serreqi, Qamil Kadri Boksi, Dyl Grizha, Maliq Bushati, Maliq Sokoli, Nok Gjeloshi, Rasim Gjyzezi, Taip Shkodra, Musa Juka, Rexhep Shala, Man Hoti,

Dom Loro Caka, Xhemal Bushati, Pater Ciril Cani, Oso B. Kopliku, etj.

Komandant i frontit të luftës u caktua Pater Ciril Canin, me gradën kapiten. Në Shkodër dokumentet theksojnë se kishin ardhur në frontin e luftës vullnetarë dhe xhandarë të komanduar nga Hasan Bushati. Në rrethina kishte vullnetarë nga Drishti, Boksi, Suma, Sheldia, Shllak, Temal, Juban etj., që ndihmuan luftëtarët në vijën e parë të luftës. Në fillim të gushtit 1920 u krijua komiteti bamirës "Grueja Shqiptare" me kryetare Shaqe Çoba. Ky komitet u gjend gjithmonë në frontin e luftës. Ndërsa të rinjët shkodran krijuan grupin e ciklistëve korier. U themelua shoqata "Hylli i Kuq", për të ndihmuar të plagosurit. Në formacionet ushtarake të luftës morën pjesë dhe 300 vullnetar nga Kosova, Plava e Gucia komando-heshin nga Hasan Feri, i biri i patriotit Jakup Feri.

Gjatë muajit gusht shkuan në Shkodër dhe mjaft vullnetar nga Kruja, Kavaja, Shijaku, Durrësi, Tirana etj., të komanduara nga Abaz Kupi e Mustafa Merlika (Kruja). Në në mbrojtje të qytetit e rrethinave të Shkodrës qëndronin qindra luftëtarë të tjerë të ardhur nga Hasi, Kukësi, Tropoja etj. Ndërsa Dukagjini ishte i tërë në mbrojtje të trojeve nga ushtritë serbo-malazeze. Gjithashtu Lezha, Mirdita e Puka qëndronin në gatishmëri.

Në Shkodër në fillim të gushtit luftëtarët mësuhan se Vlora me luftën e saj heroike e kishte detyruar pushtuesin italian të dorëzohet dhe të nënshkruar marrëveshjen me Qeverinë shqiptare për largimin e ushtrisë italiane prej saj. Dibranët dhe matjanët luftonin kundër ushtrisë pushtuese serbe. Dibranët

dhe pse ishin në luftë, ndihmuar për mbrojtjen e Shkodrës duke dërguar vullnetare. Qeveria e Tiranës në këtë periudhë përballoi dhe rebelimin e esadistëve.

### Zhvillimi i betejave

Lufta e Koplikut nisi më 27 korrik 1920. Në këtë luftë u zhvilluan betejat: më 3 gusht në Përrua të Thatë; në "Kodrat" e Koplikut ku në luftime ranë heroikisht 10 dëshmorë; në Suka te Moksetit që përsëriti heroizmin e vitit 1911; në Qytez (Hot), në qafë të Malthit. Aksionet ushtarake në fshatin Kamicë, ku u kapën mjete lundruese me furnizime të ndryshme për ushtrinë. Beteja të mëdha u zhvilluan në majë të Napujes, në majë të Krygjes, në Suk të Kolvatës, te Vorri i Papë në Kastrat. Beteja e zhvilluar në lagjen Llazan të Koplikut më 20 shtator 1920, ku trimi Zef Prel Martini luftoi heroikisht, dhe pse i plagosur, përballë një ushtrie të madhe serbo-malazeze, duke e bërë shtëpinë e thjeshtë të Lush Pep Smakajt i ngjate Kullës së famshme të "Oso Barotit" në Vranin.

Nga nisja e luftimeve edhe gjatë muajit gusht 1920 u zhvilluar disa beteja të rëndësishme kundër pushtuesëve serbo-malazez në Shkodër e ne territorin rreth saj. Luftime u zhvilluar në Bardhaj, rreth Kishës së Traboinit. Të tjera beteja u zhvilluan në të gjithë territorin e Malësisë së Madhe. Ndërsa Kopliku gjatë gjithë kësaj lufte mbrojtëse u bë qendra e veprimeve organizative e luftarake të çlirimit e mbrojtjes së territoreve shqiptare nga ushtria serbo-malazeze. Në Koplik që ishte vatra kryesore e luftimeve, u strehuan mjaft

luftëtar dhe drejtues të luftës. Drejtues dhe luftëtarë të Koplikut në dokumentet e kohës flitet për Cuf Brahimi, Kadri Selmani, Dyllo Meti, Zeqir Hoti, Bel Cufaj, Nikoll Zefi, Ibrahim Sejdi, Dik Cufaj, Hajdar Meta, Beqir Curri, Cul Istrefi, Sejdi Fili, Hajdar Curri, Musa Selimi, Bajram Rexha, Hajdar Duli, Zek Zeneli, Sylo Haxhia, Beqir Zeneli, Ramadan Sejdi, Çun Zeqiri, Abdyl Bajraktari, Cuf Rexhepi, Elez Ujka, etj.

Në të gjitha beteja e zhvilluara nga çetat dhe grupçetat u shfaqën dukshëm përvoja ushtarake shqiptare e grumbulluar në shekuj. Komandanët dhe luftëtarët u shquan në kapjen me shpejtësi të pozicioneve dhe në shfrytëzimin e terrenit me mjeshhtëri, ku armiku nuk bëri dot hap përpara. Të gjitha sulmet e ushtrisë serbo-malazeze dështuan në saj të këmbënguljes dhe të njohjes të mirë të terrenit, të ngritjes së kurtheve dhe të fortifikimit të thjeshtë të bërë në përshtatje me terrenin. Pavarësisht se ushtria serbe ishte e kompletuar me armët më moderne të kohës, luftëtarët shqiptarë u shquan në përdorimin me mjeshhtëri të armëve, të ngritjes së pritave, të sulmeve të befasishme të tyre, të studimit të mirë të formacioneve të tyre, të mbështetjes së gjerë nga populli. Pavarësisht në se këtë luftë armiku hodhi në sulm mbi tre batalione të armatosur dhe të pajisur më së miri, pa llogaritur këtu edhe forcat e artilerisë dhe të prapavijës së tij, gjithmonë raporti i forcave ishte në favor të tij.

Drejtimesit e çetave manovrua shumë mirë në terrenin dhe mbajtje gjithmonë ndëlidhje me njeri-tjetrin dhe informoheshin për lëvizjet e armikut. Në çdo betejë dhe sulm të çetave të luftëtarëve, armiku u gjend në befasi të plotë. Rugët e tërheqjes së tij ishin të pakalueshme nga pritat dhe goditjet e besasishme të luftëtarëve. Në mjaft kronika të kohës prej tyre shkruhet se toka shqiptare ju rrëshqiste nën këmbë.

Lufta e Koplikut ishte një luftë për liri e pavarësi dhe ka në themel gjakun e trimave luftëtarë. Qindra të plagosur dhe dhjetra dëshmorë që shkruan histori. Lufta përfundoi më 14 shkurt 1921, ku u zhvilluan mjaft ditë lufte e sakrificave të panumërta, të bërë nga çetat, drejtuesit, luftëtarët dhe popullësia e kësaj zone trime, luftëtarë dhe heroike.

Historia e Luftës së Koplikut flet për organizimin ushtarak të luftëtarëve, që si një ushtri e rregullt zhvilluan beteja që për nga përmasat marrin vlera ushtarake si në Vrakë, në Gruemirë e Grizhë, si dhe sulmi përfundimtar në Koplikun e Sipërm mbi ushtrinë serbo-malazeze. Punë e mirë dhe e kujdesshme është bërë për listimin e emrave të të gjithë dëshmorëve të rënë në këto beteja, si në Hoti 27 dëshmorë, në Kastrati 14 dëshmorë në Shkodër dhe në rrethina mbi 15 dëshmorë etj. Lufta e Koplikut ka dhjetra dëshmorë që historia e Shqipërisë i ka në themelet e konsolidimit të pavarësisë së shtetit shqiptar. Lufta e Vlorë, Lufta e Dibris dhe Lufta e Koplikut janë themelet e Shqipërisë dhe të pavarësisë së plotë të saj.



**Q**endra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020 -2021, për 60 (gjashtëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimi universitar i përafrohet si vijon: Personel (Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti Juridik), Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik), Xhenio (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Pilot (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatik dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera) Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 17 korrik 2020. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është shtyer deri në 28 gusht 2020.

#### Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të ketë figurë të pastër morale; të mos ketë probleme me deportimin; të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (01 Gusht 2021). Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (01 Gusht 2021); të kenë gjatësinë trupore mbi 170 për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse, të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatiche, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të jenë në zotërim të diplomës së arsimit të lartë, (minimumi beachelor) brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jomë pak se 6 (gjashtë); të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i



## Akademia e Forcave të Armatosura

# Viti akademik 2020-2021, aplikoni për 60 të drejta studimi

*Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit shtyhet deri më 28 gusht 2020*



punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi.

Kandidatët që rekrutohen nga rradhët e FA-së (nga rradhët e ushtarëve dhe nënoficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se "shumë mirë"; të mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

#### Procedurat e aplikimit:

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në Aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga rradhët e ushtarëve/detarëve apo nënoficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t'ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandimin për

pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

#### Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksi A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e

dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve; fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bangat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. b) Në përfundim të testimit; Kandidatët që janë kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda 5 ditëve duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: dëshmi penaliteti; vërtetim nga gjykata; vërtetim nga prokuroria; vërtetim nga përbarimi; raporti mjekësor i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor i Njësisë Mjekësore Ushtarake. Qendra e Personel Rekrutimit të sigurojë dokumentacionin, i cili mund të shkarkohet online nëpërmjet portalit qeveritar "e-albania", sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kandidatët të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar në rastet kur për arsye teknike ai nuk mund të shkarkohet nëpërmjet portalit nga QPR-ja.

#### Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj në gjuhën anglisht do zhvillohet 01.09.2020, Testi Fizik do të zhvillohet në datë 02.09.2020, Testi Intelektual zhvillohet në datë 03.09.2020 kurse Testi Psikologjik do të zhvillohet në datë 04.09.2020.



“BREEZE SEA 2020”: 20 DERI 24 KORRIK 2020

# Grupi i Qendrueshëm Detar i NATO-s: Stërvitje dypalëshe SHBA-Ukrainë

**G**rupi i Dytë i Qendrueshëm Detar i NATO-s, (SNMG2) po merr pjesë në stërvitjen dypalëshe SHBA - Ukrainë, “Breeze Sea 2020”, që zhvillohet midis 20 dhe 24 korrikut 2020.

SNMG2 është një nga katër grupet e qendrueshme që përbëjnë thelbin e elementit detar të Forcës së Reagimit të NATO-s, dhe aktualisht është i përbërë nga tre fregate nga Spanja (ESPS Alvaro de Bazan, si flamur), Rumania (ROS Regina Maria) dhe Turqia (TCG Yildirim).

“Breeze Sea”, përsëritjen e saj të 20-të, është një stërvitje vjetore e zhvilluar në Detin e Zi në brigjet e Ukrainës, me anije, avionë dhe personel nga Bullgaria, Gjeorgjia, Norvegjia, Rumania, Spanja, Turqia, Ukraina dhe Shtetet e Bashkuara, të cilat marrin pjesë.

Ushtrimi përqendrohet në zona të shumëfishta luftarake, duke përfshirë mbrojtjen ajrore, luftën kundër nëndetëseve, kontrollin e dëmtimit, dhe kërkim shpëtimin, si dhe përfshin më shumë se 2,000 personel. Ai ndërtohet në bazë të përsëritjeve të mëparshme për të siguruar mundësi unike të trajnimit të krijuar për të rritur gatishmërinë, për të përmirësuar bashkëpunimin dhe ndërveprimin.

Suksesi i “Breeze Sea” është edhe më i jashtëzakonshëm nëse marrim parasysh rrethanat e jashtëzakonshme që rrjedhin nga COVID-19 “Profesionalizmi dhe entuziazmi i Grupit Dy Detar të Përhershëm të NATO-s po demonstron ditë pas dite, duke



bashkëpunuar me marinat aleate dhe partnerë në një skenar shumë të kërkuar si Breeze Sea”, tha Admirali Manuel Aguirre nga Marina Spanjolle, komandant i SNMG2 që nga 30 qershori

“Suksesi i Breeze Sea është edhe më i mrekullueshëm nëse marrim parasysh rrethanat e jashtëzakonshme që rrjedhin nga pandemia COVID-19.”

“Breeze Sea 2020” zhvillohet ek-

skluzivisht në det. Kjo masë paraprake lejon njësitë të forcojnë bashkëpunimin multinacional operacional, duke siguruar që ekuipazhet të mbeten të shëndetshëm dhe të gatshëm për të siguruar

mbrojtje të vazhdueshme rajonale.

Ky është një ushtrim vjetor që filloi në vitin 1997, duke i bashkuar vendet e Detit të Zi për të trajnuar dhe operuar me anëtarët e NATO-s për të ndërtohet ndërveprimin dhe për të rritur aftësinë.

Javën e kaluar SNMG2 së bashku me Grupin Dy të Qendrueshëm Kundër Minave, i NATO-s, morën pjesë në stërvitjen detare të udhëhequr nga Bullgaria me një emër të ngjashëm, Breeze 2020, gjithashtu mbajtur në Detin e Zi. Me tre kombe aleate, Bullgaria, Rumania dhe Turqia, dhe dy partnerë rajonal, Ukraina dhe Gjeorgjia në kufi me Detin e Zi, prania e Qendrueshme e Grupit Detar në rajon është një dukuri e rregullt. Përveç pjesëmarrjes në dy ushtrime, grupet po kryejnë edhe patrulla të sigurisë detare në ujërat ndërkombëtare duke rritur ndërgjegjësimin e situatës detare midis Aleatëve dhe partnerëve rajonalë. Pas përfundimit të Breeze Sea dhe një vizite të shkurtër në Odessa, Ukrainë (me ndërveprim minimal me autoritetet lokale dhe popullsinë për të minimizuar rreziqet e COVID-19) Grupi do të kryejë një patrullim detar ndërsa do të vazhdojë drejt Detit Mesdhe për të përfunduar vendosjen e dytë të Forcat detare të NATO-s në Detin e Zi në vitin 2020.

MADRID MË 15-16 KORRIK 2020

## Forcë dhe solidaritet në të gjithë Aleancën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s merr pjesë në përkujtimin e viktimave të COVID-19 në Spanjë



Derëve të NATO-s. Spanja i ka dhuruar pajisje mjekësore Irakut, ndërsa në vend, mijëra trupa spanjolle kanë luajtur një rol jetësor në mbështetjen e përpjekjeve civile për të trajtuar COVID-19. Sekretari i Përgjithshëm theksoi se Spanja nuk ka qëndruar vetëm, pasi dërgimet e furnizimeve mjekësore jetësore nga aleatët e tjerë të NATO-s kanë lehtësuar barrën për sistemin spanjoll të kujdesit shëndetësor dhe ndihmuan për të shpëtuar jetë. Mbështetja nga Republika Çeke, Estonia, Gjermania, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Polonia dhe Turqia është koordinuar përmes Qendrës së Koordinimit Euro-Atlantik të Fatkeqësive në NATO.

Sekretari i Përgjithshëm dhe min-

istri i Jashtëm spanjoll iu drejtuan përgatitjeve të NATO-s për një valë të dytë të mundshme, me një plan operacioni, një rezervë të pajisjeve mjekësore dhe më shumë fonde. Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Spanjën për kontributet e vazhdueshme në Aleancë, pavarësisht nga pandemia, përfshirë edhe përmes misioneve të NATO-s në Afganistan dhe Irak, si dhe pjesëmarrjen në Misionin e Policisë Ajrore të Balltikut dhe grupin shumëkombësh të betejave në Letoni. Sekretari i Përgjithshëm dhe ministri i Jashtëm spanjoll trajtuan gjithashtu luftën kundër terrorizmit, situatën në rajonin e Mesdheut dhe sfidat e tjera aktuale të sigurisë.

## Aeroplani i tretë mbikëqyrës i Aleancës së NATO-s mbërin në Itali

Më 15 korrik 2020, avioni i tretë i pilotuar nga distanca i Programit Aleanca Me Mbikëqyrjes Tokësore të NATO-s mbërriti në orën 13:37 me kohën lokale në bazën e saj të re në Sigonella, Itali. Zbritja shënon edhe një hap tjetër për NATO-n në rrugën e saj për të përvetësuar gjithsej pesë avionë të pilotuar nga distanca RQ-4D, të referuara si “Phoenix”, të gjithë të bazuar në Sigonella. “Fluturimi i avionëve NATO-03 nga Kalifornia në Sicili është një moment historik i rëndësishëm në Programin e Blerjes së Mbikëqyrjes në Tokë të Aleancës, tha gjeneral brigadë Volker Samanns, menaxheri i përgjithshëm i Agjencisë së NATO-s për Menaxhimin e Mbikëqyrjes së Tokës.” Pasja e tre avionëve Phoenix në Sigonella i jep Aleancës së NATO-s, Agjencisë së Menaxhimit të Mbikëqyrjes Tokësore, më shumë fleksibilitet në çështjet e testimit të punës dhe verifikimit, duke siguruar njëkohësisht pajisjet për njohje dhe trajnim”, shtoi ai.

Gjeneralbrigade Houston Cantwell, i cili mori kontrollin e Komandës së Forcës së Mbikëqyrjes Tokësore të Aleancës së NATO-s në fillim të këtij muaji, ishte në vend për të ndjekur uljen. “Ky është një debutim i shkëlqyeshëm për mua.” tha ai. “Ky është një moment tjetër i rëndësishëm në rrugën tonë për të krijuar një aftësi të përparimit të Mbikëqyrjes së Inteligjencës dhe Rindërtimit për të gjithë Aleatët e NATO-s”.

Kalim i fundit Atlantikut, nga Kalifornia në Itali u kontrollua plotësisht nga pilotët në Bazën Kryesore të Operacionit të Forcave të Mbikëqyrjes së Aleancës në Sigonella, në të njëjtën mënyrë si fluturimi i trageteve të aeroplanit të parë dhe të dytë të Aleancës së Mbikëqyrjes në tokë në fund të vitit 2019.

Phoenix u ngrit të martën, 14 korrik 2020 nga Baza e Forcave Ajrore Edvard në Kaliforni në Shtetet e Bashkuara në 07:47 me kohën lokale dhe zbarkoi në Sigonella rreth 21.8 orë më vonë. Avioni ishte planifikuar të kalonte fazën e verifikimit të performancës në nivelin e sistemit përpara se të dorëzohej zyrtarisht në Forcën e Mbikëqyrjes Tokësore të Aleancës së NATO-s. Sapo të mbërrin në pesë aeroplanët në Baza Operative kryesore e Aleancës Tokësore Mbikëqyrëse në Sigonella deri në fund të vitit 2020, sistemi i mbikëqyrjes kolektive të NATO-s në pronësi dhe operim kolektiv nga Aleanca Ground Surveillance do të sigurojë një aftësi unike të një arti më të lartë të prokuruar nga 15 aleatë dhe të shpërndarë me të gjithë 30 anëtarët e Aleancës. I gjithë sistemi i mbikëqyrjes së terrenit të Aleancës është një sistem i bërë me porosi i përshtatur në mënyrë unike në kërkesat e NATO-s dhe i krijuar posaçërisht për të përmbushur kërkesat e Inteligjencës, Mbikëqyrjes dhe Rindërtimit të identifikuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut dhe Komandanti Suprem i Aleatëve Evropë.



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Stoltenberg-Ministri japonez i Mbrojtjes Taro Kono

# Sfidat globale dhe partneriteti më i rëndësishëm se kurrë

Sekretari i Përgjithshëm përgëzon bashkëpunimin midis NATO-s dhe Japonisë

**S**ekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg foli përmes telefonit me ministrin japonez të Mbrojtjes Taro Kono të martën (21 korrik 2020), duke adresuar pandeminë COVID-19, çështjet e sigurisë rajonale dhe mënyrat për të forcuar më tej bashkëpunimin midis NATO-s dhe Japonisë.

